

Bujqësia e Qëndrueshme

Në kuadër të projektit JICA, një grup fermerësh nga zona e Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta zhvilluan një vizitë studimore në fermën "Uka Farm", Tiranë.

Uka Farm sjellë konceptin e njohur si "nga ferma në tavolinë" ose nga toka në tavolinë ku kultivohen pothuajse të gjitha kulturat e ndryshme perimore, si dhe pemët frutore.

Fermerë të ndryshëm nga zona e Divjakës të interesuar për Bujqësinë e Qëndrueshme, të shoqëruar nga profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ekspertë të Projektit JICA si edhe përfaqësues të Grupit të Punës për Bujqësinë e Qëndrueshme në Parkun Kombëtar morën pjesë në këtë vizitë studimore ku u njohën me teknikat më të mira në kultivimin e perimeve, shërbimet agroteknike, përdorimin e inputeve bujqësore të cilat praktikohen sipas standarteve të një bujqësie organike.



Punonjësit e Parkut



Fotjon Prence është Shefi i Sektorit të Monitorimit në Administratën e Zonave të Mbrojtura të Qarkut të Fierit.

Ai përgjigjet për zbatimin e legjislacion për zonat e mbrojtura të Qarkut Fier, atë të Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta, Parqet Natyrore Levan, Pish Poro dhe Vjosë. Bën konstatimet për shkeljet dhe veprimet e paligjshme që ndodhin në Zonat e Mbrojtura.

Gjithashtu ndjek monitorimin biologjik të florës dhe faunës në zonën e parkut. Bashkëpunon për ruajtjen dhe mbledhjen e të dhënave për zonën e mbrojtur, për kufijtë, zonimin, aktivitetet, etj. Në sektorin e monitorimit të Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta janë 10 Ranger të cilët meren me ruajtjen dhe monitorimin në zona të ndryshme të parkut.

BULETINI INFORMATIV

PER MUAJIN GUSHT 2022

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta



Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë
Tel: (+355) 69 890 0540
Email: dknpmia@hotmail.com

SCAN ME



Instagrami i
Projektit JICA

SCAN ME



Facebook
AdZM Fier

Masat për Sedimentimin

Edhe gjatë ketij muaji ka vijuar puna për studimin e problemit të sedimentit dhe dinamikës së bregdetit në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë Karavasta.

Experti Japonez, Dr. Daiki Tsujio prezantoi në mbledhjen e grupit të punës çështjet lidhur me gjetjet e deritanishme mbi sedimentet dhe ndryshimet e gjëndjes së ujit.

Ai shpjegoi dhe mekanizmat e levizjes së sedimenteve si dhe shkëmbimin e ujrave mes detit dhe lagunës.

Puna do të vazhdojë edhe më tej deri në përgatitjen e një raporti final.



JO PLASTIKES !

Një qese plastike zakonisht mund të përdoret për vetëm 30 minuta, por do të duhen shumë e shumë vite për t'u dekompozuar. Shumë prej tyre hidhen në lumenj e më pas përfundojnë në det, ku shkaktojnë shumë probleme.

Në kuadër të Ditës Botërore pa canta plastike, specialistët e AdZM Fier me mbështetjen e projektit JICA zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësimi duke shpërndarë trasta prej pëlhere në marketet, që ushtrojnë aktivitet në Parkun Kombëtar Divjakë- Karavasta.

Këto trasta mund të përdoren disa herë, duke reduktuar kështu përdorimin e plastikës. Ky aktivitet i ndërmarrë, ecën paralelisht edhe me nismën e qeverisë për reduktimin e plastikës.



Mbrojtja e Parkut nga Zjarret



Periodha e verës është periodha më e vështirë për sa u përket zjarreve në parkun Kombëtar. Staf i AdZM Fier është i vendosur në gadishmëri në disa pika vrojtimi për të bërë të mundur parandalimin e këtyre zjarreve ose fikjen e tyre.

Rastet më problemaktike vijnë nga pastrimet që fermerët u bejnë tokave të cilat ndodhen shumë afër me fondit pyjor, gjatë kohës ku ata djegin papastërtitë era favorizon zjarrin duke e nxjerrë jashtë kontrollit. Ka edhe raste ku zjarret janë të ndezura qëllimisht ose nga pakujdesia gjatë piknikeve që organizojnë qytetarët pranë parkut. AdZM Fier me anë të traktorit të ofruar nga projekti JICA mirëmban rregullisht koridoret në brëndësi të pyllit me pisha për të qënë në gadishmëri për cdo lloj situatë.

